

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7959
E martë, 24 dhjetor 2024
Çmimi 0.50

BQK-ja përmbyll
paraaplikimin për SEPA
të Komisionit Evropian



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



PARTIA MË E MADHE E SERBËVE NË KOSOVË NUK ËSHTË LEJUAR TË MARRË
PJESË NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË 9 SHKURTIT

KQZ-ja NUK E CERTIFIKON LISTËN SERBE PËR ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk e ka certifikuar Listën Serbe, partinë më të madhe të serbëve në Kosovë, për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Përfaqësues të partisë në

pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, kanë dalë kundër certifikimit të kësaj partie. Për certifikimin e kësaj partie ka votuar vetëm kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, kundër kanë dalë dy anëtarët e LV-së, Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi, ndërsa të

tjerët kanë abstenuar. Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se moscertifikimi i Listës Serbe duket më shumë si vendim i motivuar politikisht sesa i bazuar në kriteret ligjore

**HAXHIU GODET
PROKURORINË
SPECIALE:
GJITHMONË
KA DËSHIRË
TA DËMTOJË
VETËVENDOSJEN**

F. 7



**ÇEKU: SERBIA
ËSHTË LUFTËS SË
FUNDIT NË KOSOVË
KA SHKATËRRUAR
MBI 1 800 MONUMENTE
E 1.7 MILION
LIBRA SHOQP**

F. 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renovamt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

**"NDIHMA" KORRUPTIVE,
PËR VOTA
TË KORRUPTUARA!** F. 5

Reagim
i KMDLNj-së



AKTUALE



**LËVDATA E KRITIKA NË SHQIPËRI
PËR NDALIMIN E "TIKTOK"-UT** F. 3

**HILL: SHBA-JA NUK SHEH PROVA QË
E LIDHIN BEOGRADIN ME SULMIN NË
IBËR-LEPENC** F. 6

EKONOMI

**QEVERIA UA NDAN NGA 100 EURO
PENSIONISTËVE DHE FËMIJËVE DERI
NË 16 VJEÇ** F. 8

**THIRRJE PËR TRANSPARENCË DHE
LLOGARIDHËNIE NGA TERMOKOS-I
DHE ZRRË-JA NË LIDHJE ME
FATURIMIN E ENERGJISË TERMIKE** F. 8

SPORT



**LLAPI NDAHET ME AVDYLIN: ISHTE KYÇ
NË SUKSESET E KLUBIT** F. 10

Presidentja e Gjeorgjisë kërkon që data e zgjedhjeve të caktohet deri më 29 dhjetor

Tbilisi, 23 DHJETOR - Presidentja e Gjeorgjisë, Salome Zurbishvili, i ka bërë thirrje partisë në pushtet, Ëndrra Gjeorgjiane, mike e Moskës, të caktojë një datë për zgjedhjet e reja parlamentare deri më 29 dhjetor, mes trazirave mbi votimin e fundit dhe vendimit të njëanshëm të partisë për t'i shtyrë negociatat me Bashkimin Evropian.

Zurbishvili ka qenë e bllokuar në një përplasje me partinë që kur fitoi zgjedhjet parlamentare të tetorit, të mbizotëruara nga akuzat për mashtrime zgjedhore. Opozita ka refuzuar ta njohë votimin, duke akuzuar Ëndrrën Gjeorgjiane për manipulim të votave për ta marrë pushtetin. Në një fjalim vonë më 22 dhjetor, ajo ftoi miliarderin miqësor me Rusinë, Bidzina Ivanishvili, një ish-kryeministër dhe themelues i Ëndrrës Gjeorgjiane, në pallatin presidencial për bisedime mbi caktimin e datës së zgjedhjeve. Ëndrra Gjeorgjiane ka mohuar çdo keqëbërje në zgjedhje dhe ka refuzuar të marrë në konsideratë zgjedhje të reja pavarësisht prej protestave pothuajse të

përditshme për fitoren e saj dhe vendimit të saj pasues për t'i ndërprerë bisedimet me BE-në deri në vitin 2028. "Ivanishvili duhet të vijë në pallat dhe unë jam gati të ulem dhe të mendoj se si duhet të caktohen zgjedhjet. Për datën e zgjedhjeve duhet të bihet dakord deri më 29 dhjetor", tha Zurbishvili në një tubim në Tbilis, vendi i protestave të panumërta gjeorgjiane.

Për shkak të problemeve teknike gjatë fjalimit, Zurbishvili tha se do të publikonte një mesazh të ri me video më 23 dhjetor.

Gjeorgjia mori statusin e kandidatit në BE në dhjetor të vitit të kaluar, por lidhjet me Brukselin kanë qenë të tensionuara muajt e fundit pas miratimit në maj të një ligji të diskutueshëm për "agjentët e huaj" të shtyrë në parlament nga Ëndrra Gjeorgjiane, e cila ka qeverisur që nga viti 2012.

Kritikët thonë se legjislacioni kërcënon mediet dhe grupet e shoqërisë civile dhe pasqyron një ligj të ngjashëm rus të përdorur nga Kremli për t'i mbytur kundërshtarët politikë



dhe shoqërinë civile.

Ndërsa fillimisht e miratuar nga Ëndrra Gjeorgjiane për kandidimin e saj të suksesshëm presidencial në vitin 2018, Zurbishvili ka qenë një gjemb për partinë në pushtet.

Edhe pse zyrtarisht një presidente jopartiake e kufizuar në një rol ceremonial, Zurbishvili ka kritikuar Ëndrrën Gjeorgjiane për qëndrimin e saj gjithnjë e më autoritar.

Në fillim të këtij muaji, një kolegji zgjedhor i dominuar nga Ëndrra Gjeorgjiane zgjodhi Mikheil Kavelashvili, një ish-futbollist 53-

vjeçar dhe populist i krahut të djathtë, si presidentin e ardhshëm të Gjeorgjisë. Inaugurimi i tij supozohet të bëhet më 29 dhjetor, megjithëse 72-vjeçarja Zurbishvili, mandati i së cilës përfundon këtë vit, ka thënë se nuk do të shkojë askund.

Pasi partia në pushtet Ëndrra Gjeorgjiane shpalli fitoren në zgjedhjet e 26 tetorit, protestat rifilluan dhe u shtuan pasi qeveria tha se po pezullonte bisedimet me Brukselin mbi ofertën e Tbilisit për t'u bashkuar me BE-në, donatori më i madh i

Gjeorgjisë, tregu më i madh ekonomik dhe shtëpi për shumicën e diasporës së saj. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) tha në raportin e saj përfundimtar mbi zgjedhjet të cilin e publikoi më 20 dhjetor, se shumë çështje "ndikuan negativisht" në zgjedhje dhe gërryen besimin e publikut. Raporti i referohet miratimit të ligjit për "agjentët e huaj", të modeluar sipas një ligji të ngjashëm rus, duke thënë se zgjedhjet u zhvilluan mes "shqetësimeve serioze për ndikimin e legjislacionit të miratuar së fundmi mbi liritë themelore dhe shoqërinë civile". Ligji, i cili urdhëron që organizatat që marrin fonde të konsiderueshme të huaja të regjistrohen si agjentë të huaj, hyri në fuqi më 1 gusht, duke shkaktuar reagime të konsiderueshme nga aktorët ndërkombëtarë dhe vendës. Qeveria javën e kaluar u zotua të amendamentojë ligjin, megjithëse nuk dha hollësi për ndryshimet që do të miratonte.

Putini takohet me kryeministrin slovak në Moskë, bisedojnë për gazin

MOSKË, 23 DHJETOR - Presidenti rus Vladimir Putinin dhe kryeministri slovak Robert Fico u takuan në Kremlin më 22 dhjetor për të diskutuar për një kontratë që skadon së shpejti, e cila lejon kalimin e gazit natyror rus përmes Ukrainës. Fico tha se takimi me Putinin ishte si reagim ndaj Ukrainës, e cila tha se nuk do ta rinovojë kontratën, që do të përfundojë më 31 dhjetor. "Putini konfirmoi gatishmërinë e [Rusisë] për ta vazhduar furnizimin me gaz në Perëndim dhe në Sllovaki", shkroi Fico në "Facebook".



Fico tha se me Putinin shkëmbyen pikëpamje për situatën ushtarake në Ukrainë, mundësinë e një zgjidhjeje paqësore të luftës dhe marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet Sllovakisë dhe Rusisë. Kryeministri slovak është një nga liderët e paktë evropiane me

të cilët Putini ka mbajtur lidhje që kur Moska filloi pushtimin e saj në shkallë të plotë të Ukrainës gati tre vjet më parë.

Fico mbërriti në Rusi për "vizitë pune" dhe u takua me Putinin kokë më kokë, siç u citua të ketë thënë zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, më parë më 22 dhjetor.

Sipas raporteve të medieve ruse, Peskov tha se takimi do të fokusohet në "situatën ndërkombëtare" dhe ka të ngjarë t'i prekte furnizimet me gazin natyror rus.

Sllovakia dhe Hungaria, të cilat

mbështeten në gazin rus, ngritën shqetësime për mundësinë e humbjes së furnizimeve pasi Ukraina tha se nuk do ta rinovonte kontratën.

Fico, pikëpamjet e të cilit për luftën e Rusisë ndaj Ukrainës ndryshojnë nga ato të shumicës së liderëve evropianë, u kthye në pushtet vitin e kaluar pasi partia e tij e majtë Smer (Drejtimi) fitoi zgjedhjet parlamentare në një platformë proruse dhe antiamerikane.

Që atëherë ai i ka dhënë fund ndihmës ushtarake të vendit të tij për Ukrainën, ka goditur

sanksionet e BE-së ndaj Rusisë dhe është zotuar ta bllokojë bashkimin e Ukrainës me NATO-n.

Vizita e liderit të vendit anëtar të NATO-s dhe BE-së nuk ishte paralajmëruar më parë, por Fico tha se zyrtarët e lartë të BE-së ishin informuar për udhëtimin e tij dhe qëllimin e tij më 20 dhjetor.

Michal Simecka, kreu i partisë opozitare, Sllovakia Progresive, e përshkroi udhëtimin e Ficos për ta takuar Putinin si një "turp për Sllovakinë dhe një tradhti të interesave kombëtare".

Të paktën 20 të vrarë nga sulmet izraelite në Gazë

GAZA, 23 DHJETOR - Të paktën 20 njerëz, përfshirë pesë fëmijë, janë vrarë si pasojë e sulmeve izraelite gjatë së shtunës në mbrëmje dhe të dielën në mëngjes, thanë zyrtarët shëndetësorë palestinezë.

Ndërkohë, autoritetet izraelite lejuan kardinalin Pierbattista Pizzaballa, i cili është udhëheqësi i Kishës Katolike në Tokën e Shenjtë, të hyjë në Gazë për të marrë pjesë në një meshë para Krishtlindjes me anëtarët e komunitetit të vogël të krishterë

në enklavë.

Një sulm ndaj një shkollë që strehonte njerëz të zhvendosur në qytetin Gaza la të vdekur të paktën tetë njerëz, përfshirë tre fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë së Gazës. Mbrojtja Civile, e lidhur me qeverinë e drejtuar nga Hamasi, tha më herët se katër fëmijë ishin në mesin e të vrarëve.

Ushtria izraelite deklaroi se kreu një sulm preciz ndaj militantëve të Hamasit që strehoheshin aty.



Lëvdata e kritika në Shqipëri për ndalimin e "TikTok"-ut

Tiranë, 23 dhjetor - Të rinj të anketuar nga Radio Evropa e Lirë në Tiranë, kanë mendime të ndryshme lidhur me vendimin e Qeverisë së Shqipërisë për mbylljen e platformës "TikTok" për një vit. Ndërsa për ekspertë të edukimit, komunikimit e të zhvillimit psiko-social të fëmijëve, vendimi është i drejtë, por jo i mjaftueshëm. Valmir Visha, 25 vjeç, e konsideron "vendim të vonuar". "Është një platformë pa filtra, ku kushdo mund të promovojë çfarë të dojë, edhe dhunë. Mjafton të jesh viral", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Ardit Minarolli, 18 vjeç, mendon se qeveria shqiptare është nxituar me marrjen e këtij vendimi. "Jetojmë në një botë demokratike dhe digjitale. Mbyllja e rrjeteve sociale kufizon edhe liritë e të shprehurit. Mund të gjenden mënyra për të pasur filtra, kontrolle, por jo mbyllje", thotë ai.

Një tjetër 18-vjeçar, Blevis Allushi, konsideron se vendimi është një masë e papërshtatshme për ta zgjidhur problemin e dhunës te të miturit. "TikTok-u" nuk është problemi, problemi janë disa krijues, të cilët abuzojnë me normat, dhe disa konsumues të cilët marrin mesazhet e gabuara", thotë ai. "Ta ndalosh 'TikTok'-un për ta shmangur dhunën nuk është zgjidhje dhe, gjithashtu, dëmton shumë persona të tjerë që janë përdorues aktivë", thotë Kevin Jaku, 28 vjeç, duke shtuar se edhe pse "TikTok"-u është një ndër aplikacionet më të përdorura, mund të zëvendësohet shumë shpejt nga një tjetër platformë.

Vendimin për mbylljen e "TikTok"-ut nga 1 janari në nivel vendi e bëri publik kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pas, siç është thënë, disa konsultave që kryeministri dhe ministrja e Arsimit, Ogerta Manastirliu, zhvilluan me prindër dhe mësues.

Deri tani ende nuk ka një vendim zyrtar të publikuar nga qeveria.

Shkak për këtë vendim u bë ngjarja tragjike e 18 dhjetorit, ku një 14-vjeçar u vra me



thikë nga një bashkëmohatar i tij pranë shkollës "Fan Noli" në Tiranë. Kompania që menaxhon platformën sociale "TikTok" reagoi për agjencinë "Associated Press" duke thënë se donte "sqarime urgjente nga qeveria shqiptare". Kompania tha se "nuk kishte gjetur ndonjë provë që autori ose viktimat të kishte llogari 'TikTok' dhe raportimet e shumta, në fakt, kanë konfirmuar se videot që çuan në këtë incident ishin postuar në një platformë tjetër, jo në 'TikTok'".

Rama tha se ky qëndrim i kompanisë do të thotë se nuk është kuptuar serioziteti i kërcënimit që ajo platformë ka sjellë për fëmijët dhe rininë. Luiza Myrtaj-Nezha, mësuese në shkollën "Skënder Luarasi" në Tiranë, thotë se mbyllja e "TikTok"-ut është masë e pamjaftueshme për ta luftuar fenomenin e dhunës, agresivitetit dhe ngacmimit te të miturit. Ajo thekson se mbyllja nuk e zgjidh problemin, pasi ka platforma të tjera ku fëmijët sërish do të ndeshen me përmbajtje të papërshtatshme. "Duhet

ndërmarrë hapa të tjerë për t'ia bashkëngjitur këtij vendimi për ta luftuar fenomenin e dhunës te të miturit", thotë Myrtaj. Isa Halilaj, zëvendës-president i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, thotë se për të zgjidhur këtë problem duhet të ndërmerren disa hapa të tjerë para se të shkohet te mbyllja e platformave sociale. "Arsimi duhet të jetë prioritet kombëtar. Duhet buxhet më i lartë për arsimin dhe disa reforma. Shkolla duhet të hapet, dyert e saj duhet të jenë të hapura për fëmijët deri në orën 16:00, të kenë mundësinë të ushqehen aty, të ketë aktivitete edukuese pas procesit mësimor", thotë Halilaj. Sipas tij, edhe shërimi psikologjik në shkollë është shumë i mangët.

Por, Edlira Dyrnashaj, psikologe klinike, thotë se është për kufizim edhe të rrjeteve të tjera sociale për fëmijët dhe të rinjtë. "E them këtë pasi nisem nga studimet shkencore mbi ndikimin e 'TikTok'-ut dhe nga qëllimi kryesor që është rritja në mënyrë të shëndetshme e fëmijëve tanë. A do ta ulë

dhunën e agresivitetin? Mendoj se është një mjet më pak", thotë ajo. Dyrnashaj thekson se mënyra si funksionon platforma është shqetësuese. E para është përmbajtja që ka dhe e cila është më e predispozuar të ofrojë material jo të përshtatshëm për të miturit. Pasojat, thotë, se janë të shumta. "Çon në deformime deri organike të trurit të fëmijëve. Lidhja mes 'TikTok'-ut e varësive është shqetësim i madh në mesin e psikologëve për faktin se si platforma i shfrytëzon proceset neurobiologjike që e rregullojnë kënaqësinë në sistemin tonë nervor si dhe motivimin e ndërtimin e zakoneve".

Por, opozita në Shqipëri sheh arsye politike pas vendimit për ta mbyllur platformën "TikTok" në Shqipëri. Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, e cilësoi vendimin një akt censure në prag të zgjedhjeve parlamentare që do të mbahen më 11 maj. Edhe deputetja demokrate Ina Zhupa, kryetare e Komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, tha se

interesi elektoral është motivi i vërtetë i kërkesës për mbylljen "TikTok"-ut.

Analisti politik Armand Shkullaku thotë për REL-in se mënyra se si u mor ky vendim në mënyrë të papritur dhe pa një konsultim të gjerë ngre dyshime serioze për arsyet që kanë çuar deri këtu. "Në këtë rast u tha dhe shifra 90 për qind e prindërve janë dakord për mbylljen e 'TikTok'-ut, pa na sqaruar ku u bazua, si u bë kjo matje?! Siguria dhe edukimi i fëmijëve janë çështje të qeverisë, jo të një platforme sociale", thotë Shkullaku.

Duke iu referuar shteteve të tjera që kanë marrë masa kufizuese ndaj "TikTok"-ut, ai thekson se kjo është bërë përmes një konsultimi të gjerë me edukatorë, mësues, prindër, sociologë, psikologë, filozofë.

Shkullaku thekson se është për çdo lloj diskutimi për të debatuar një fenomen, ndikimin e rrjeteve sociale, një program televiziv, por kundër mbylljes pasi e konsideron akt censure.

Çfarë është "TikTok"?

Aplikacioni videove të shkurtra është në pronësi të kompanisë kineze "ByteDance". Për dallim prej algoritmeve të rrjeteve të tjera sociale, algoritmi i "TikTok"-ut i jep më shumë prioritet përmbajtjes, varësisht prej preferencave të përdoruesve dhe kërkimit të përmbajtjes sesa numrit të ndjekësve që ka një llogari. Sipas një analize të agjencisë "Pikasa Analytics", që bën monitorimin e përmbajtjes së medieve në Ballkan, postimet e personave "të panjohur" po bëhen më të popullarizuara sesa ato të figurave me ndikim.

Në Shtetet e Bashkuara dhe në Kanada punëtorëve federalë u është ndaluar instalimi i aplikacionit në pajisje të punës, kurse Australia ka miratuar një projektligj që do t'ua ndalojë fëmijëve nën moshën 16-vjeçare përdorimin e rrjeteve sociale.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve zgjedh 12 anëtarët e rregullt

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në mbledhjen e Kuvendit Zgjedhor ka zgjedhur anëtarët e rregullt të saj.

Anëtarë të rregullt (akademikë). I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi. II. Seksioni i Shkencave Shoqërore: Arsim Bajrami, Besnik Krasniqi dhe

Frashër Demaj. III. Seksioni i Shkencave të Natyrës: Arsim Morina dhe Salih Gashi. IV. Seksioni i Arteve: Xhevdet Xhafa. Ndërkaq anëtarë korrespondentë. I. Seksioni i

Shkencave Shoqërore: Muhamet Mala. II. Seksioni i Shkencave të Natyrës: Enver Hamiti. III. Seksioni i Arteve: Ismet Jonuzi dhe Zake Prelvukaj.





PARTIA MË E MADHE E SERBËVE NË KOSOVË NUK ËSHTË LEJUAR TË MARRË PJESË NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË 9 SHKURTIT

KQZ-ja nuk e certifikon Listën Serbe për zgjedhjet e 9 shkurtit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk e ka certifikuar Listën Serbe, partinë më të madhe të serbëve në Kosovë, për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Përfaqësues të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, kanë dalë kundër certifikimit të kësaj partie. Për certifikimin e kësaj partie ka votuar vetëm kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, kundër kanë dalë dy anëtarët e LV-së, Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi, ndërsa të tjerët kanë abstenuar. Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se moscertifikimi i Listës Serbe duket më shumë si vendim i motivuar politikisht sesa i bazuar në kriteret ligjore

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar koalicionin AAK - Nisma Socialdemokrate, Konservatorët E30 dhe Ideal, por jo edhe Listën Serbe. Shkak për këtë kundërshtim ishin thirrjet nacionaliste të kryetarit të Listës Serbe në Kosovë, Zllatan Ellek, të bëra gjatë prezantimit të listës zgjedhore. Përfaqësues të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, kanë dalë kundër certifikimit të kësaj partie. Për certifikimin e kësaj partie ka votuar vetëm kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, kundër kanë dalë dy anëtarët e LV-së, Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi, ndërsa të tjerët kanë abstenuar. "Përfaqësues të kësaj Liste mbajnë kontakte të vazhdueshme, shihen edhe nëpër fotografi, edhe në televizion me pushtetin e [presidentit serb, Aleksandar] Vuçiçit, por ku shihet edhe Radoiçiqi", ka thënë Kurteshi, në arsyetimin e tij pse nuk duhet të certifikohet kjo parti. Kurteshi e ka përmendur që një

tjetër arsye për moscertifikim të Listës Serbe është që ajo parti nuk e ka dënuar asnjëherë sulmin në Banjskë, dhe që nuk është distancuar asnjëherë nga "aktet terroristar që kanë ndodhur në Kosovë". Kundër certifikimit të Listës Serbe doli edhe anëtar i tjetër i LV-së, Alban Krasniqi, i cili kërkoi veprime nga Prokuroria e Shtetit. Edhe anëtarët e tjerë që vijnë nga radhët e opozitës kanë shprehur shqetësimet e tyre, ndërsa përfaqësuesi i Partisë Demokratike në KQZ, Arianit Elshani, ka kujtuar se verifikimi i listave të kandidatëve ka kaluar nëpër disa institucione dhe asnjë prej tyre nuk ka dhënë ndonjë vërejtje. "Ndaj të njëjtat shqetësime me anëtarin e LV-së, mirëpo kam një shqetësim tjetër për shkak se rekomandimi i Zyrës për Regjistrim të Partive ka thënë se ky subjekt plotëson të gjitha kriteret që të jetë në garë për zgjedhjet e 9 shkurtit. Është bazuar edhe në deklaratimet e MPB-së dhe MPJ-së dhe të gjithë kanë thënë se subjekti në fjalë i plotëson kriteret. Unë me këtë rast abstenoj deri në

definimin e saktë sepse certifikimi i subjekteve duhet ta ketë një konsensus të përbashkët", u shpreh Elshani. Ai ka kujtuar se edhe Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka dhënë asnjë vërejtje për listën kandidatëve të subjektit politik. "Të gjithë e dimë se kush është Lista Serbe, mirëpo është mirë me na tregu Ministria e Punëve të Brendshme. Është mirë me tregu se kush janë pjesëtarët e këtij subjekti politik. Unë propozoj që të diskutoni me MPB-në dhe të vini me një rekomandim, qoftë për apo kundër certifikimit", u shpreh më tutje Elshani. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike është organ që vlerëson nëse një parti plotëson kriteret për pjesëmarrje në zgjedhje dhe ia dërgon rekomandimet panelit të KQZ-së. Lista Serbe pati thënë se do të marrë pjesë në zgjedhje pas një periudhe të bojkotimit të proceseve politike në Kosovë. Përgjatë takimit të së hënës, KQZ-ja e ka certifikuar grupin e dytë të partive politike -16 sosh me 626 kandidatë për deputetë. Më 18 dhjetor është certifikuar grupi i parë 11 subjekte politike

Kryeziu: Moscertifikimi i Listës Serbe duket më shumë si vendim i motivuar politikisht sesa i bazuar në kriteret ligjore

Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka komentuar këtë vendim të KQZ-së, duke thënë se edhe pse KQZ-ja përbëhet nga përfaqësues të partive politike, vendimet e saj nuk duhet të jenë të motivuara nga përkatësitë partiake të tyre, por duhet të bazohen në Kushtetutë dhe ligj. "Moscertifikimi i Listës Serbe duket më shumë si vendim i motivuar politikisht sesa i bazuar në kriteret ligjore. Ky rast është një ndër disa raste të tilla kur KQZ-ja ka marrë vendime të ngjashme, por që më vonë janë ndryshuar apo rrëzuar nga PZAP-ja, çka dëshmon mungesën e koherencës dhe profesionalizmit në punën e këtij institucioni", ka thënë Kryeziu. Ai ka shtuar se Zyra për Regjistrimin e Partive Politike ka rekomanduar certifikimin e

këtij subjekti, duke konstatuar se ai i plotëson kriteret ligjore. "KQZ-ja do të duhej të mbështetet në këtë rekomandim dhe udhëzimet e institucioneve të tjera dhe të veprojë në përputhje me ligjin. Nuk duhet të ngatërrohen qëndrimet politike apo deklaratat individuale të anëtarëve të një partie me kriteret për certifikim. Nëse kjo praktikë do të zbatohet për të gjitha partitë, atëherë shumë prej tyre nuk do të duhej të certifikoheshin. Për më tepër, nëse institucionet përgjegjëse, përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme, kanë kaluar të gjithë këta kandidatë nëpër filtrat e nevojshëm për t'u certifikuar, atëherë KQZ-ja nuk duhet të ndërhyjë me një vendim mbi kriteret dhe vlerësimet që janë kompetencë e këtyre institucioneve", ka deklaruar Kryeziu.

me 606 kandidatë për deputetë. Në total, në zgjedhjet e 9 shkurtit do të garojnë 27 parti politike. Prej tyre, 19 janë parti politike, pesë koalicione, dy nisma qytetare dhe një kandidat i pavarur. Numri i kandidatëve për

deputetë ka shkuar në 1.232. Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit përbëjnë procesin e parë të rregullt zgjedhor në Kosovë, pas shpalljes së pavarësisë më 2008. Deri më tani janë mbajtur një mori zgjedhjesh të parakohshme.

REAGIM I KMDLNJ-SË

“Ndihma” korruptive, për vota të korruptuara!

Ashtu siç pritej, Qeveria e Kosovës futi thellë duart në buxhetin e Kosovës duke ndarë “ndihma” për fundvit për fëmijët nga 0 deri në 16 vjet dhe pensionistë që nënkupton se secili “përfitues” do të fitojë nga 100 euro. Për fëmijët, pavarësisht statusit material që e kanë, “ndihma” do t’i përfshijë të gjithë, që nga kryeministri e deri te zyrtari i fundit. Kategoria më e cenueshme në Kosovë - pensionistët duket të jenë humbësit më të mëdhenj dhe me ta qeveria manipulon më së shumti për faktin se përbëjnë një trup të madh votues, edhe si individë ashtu edhe me familje. Qeveria e Kosovës, thuaja në fund të mandatit të plotë qeverisës ka ngritur pensionet për 20 për qind në kohën kur vendet e rajonit i kanë ngritur shumë herë, në përputhje me shkallën e inflacionit. Nëse qeveria e Kosovës do ta bënte indeksimin e pensioneve dhe pagave për këto katër vite ku rryma dhe artikujt e domosdoshëm të shportës familjare janë rritur mbi 100 për qind, atëherë rritja e pensioneve prej 20 për qind do

të ishte më zgjidhje e pranueshme, deri në krijimin e kushteve më të mira. Pasi u refuzua indeksimi e që parashihet me ligjet në fuqi, pensionet u zhvleftësuan në masën 30 - 40 për qind dhe në këtë mënyrë edhe me rritjen prej 20 përqindësh plus ato vitrat nga 100 euro, vlera e pensioneve është diku 85 - 90 për qind e vlerës reale në fillim të mandatit qeverisës prandaj qeveria e Kosovës jo që nuk i ka ndihmuar pensionistët por i ka varfëruar edhe më shumë. Pjesa më e madhe e familjeve kosovare përballen me fatura të papërbalueshme të rrymës, tatimit në pronë dhe blerjen e artikujve elementarë për mbijetesë që përbëjnë shportën familjare. Prandaj janë të detyruar të marrin kredi, sidomos te institucionet mikrofinanciare që ua rrjepin shtatë palë lëkura, për të mbijetuar, nga muaji në muaj. Ndarja e “ndihmave”, një muaj e gjysmë para zgjedhjeve është, pa asnjë dyshim korupsion institucional ku, pa asnjë skrupull moral e përgjegjësi institucionale caktohet vlera e votës e që është 100 euro. KMDLNj e denoncon këtë



veprim korruptiv për të fituar vota klienteliste dhe kërkon të hetohet baza ligjore e ndarjes së “ndihmave”, pa përfillur kriteret sociale sepse ka për qëllim të ndërhyjë drejtpërdrejtë në procesin zgjedhor dhe rezultatin e zgjedhjeve. KMDLNj gjithashtu kërkon që subjektet politike të jenë më të kujdesshme gjatë premtimeve për rritje të pagave dhe pensioneve sepse këto oferta po i tejkalojnë gjasat reale minimale nëse kemi

parasysh mundësitë buxhetore e që janë në shpërputhje të mëdha me premtimet. Veprimi i qeverisë është shpërdorues dhe korupsion institucional sistematik për të blerë vota për faktin se këto “ndihma” aspak nuk ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe është një veprim paliativ që po përdoret si terapi për qetësim për pjesën më të madhe të qytetarëve të Kosovës që po përballen me probleme të mbijetesës. KMDLNj thërret votuesit të

tregohen të kujdesshëm para kutive të votimit duke u përcaktuar vetëm për propozimet që kanë mundësi të përmbushen. KMDLNj - ë ua përkujton votuesve që është e drejtë e njeriut por edhe detyrim ligjor të votojnë dhe gjithashtu është e drejtë e njeriut të kërkojnë përmirësimin e kushteve të jetës përmes sigurimit të të ardhurave që ua mundësojnë një jetë të dinjitetshme nga puna apo pensioni i tyre.

BQK-ja përmbyll paraaplikimin për SEPA të Komisionit Evropian

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Banka Qendrore e Kosovës më 20 dhjetor ka dorëzuar paraaplikacionin e përditësuar me ligjet përkatëse të miratuara nga Kuvendi dhe rregulloret e nxjerra nga Bordi i BQK-së, në plotësim të paraaplikimit të dorëzuar më 14 tetor 2024. Paraaplikimi paraprak referohej në draft ligjet si ishin në atë kohë, por DG FISMA si autoritet kompetent i Komisionit Evropian njoftoi me shkrim se të njëjtat mund të shqyrtohen vetëm pas miratimit përfundimtar të legjislacionit përkatës. Prandaj, menjëherë pas miratimit të tri ligjeve të rëndësishme për sektorin financiar dhe që lidheshin direkt me procesin e anëtarësimit në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA), si: Ligji për Bankat, Ligji për Shërbimet e Pagesave dhe plotësimin/ndryshimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (më 5 dhjetor 2024), Bordi i BQK-së miratoi njëzet rregulloret përkatëse (më 17 dhjetor 2024) të cilat hyjnë në fuqi vetëm me hyrjen në fuqi të ligjeve respektive. Këto krijuan mundësitë për kompletimin e

procesit të paraaplikimit në SEPA, me pakon legjislative dhe rregullative. Ligjet dhe rregulloret e lartpërmendura ishin identifikuar si kriteret të domosdoshme për plotësimin e paraaplikimit për t’u dhënë mundësi institucioneve relevante të Komisionit Evropian të procedojnë më tej me realizimin e kësaj faze të shqyrtimit preliminar të përmbushjes së kriterëve nga ana e Kosovës, në pajtim me praktikën që kanë ndjekur për

vendet e rajonit. Pas këtij hapi, në varësi të trajtimit nga Komisioni Evropian të çështjeve lidhur me hyrjen në fuqi të këtyre ligjeve, nëse shqyrtimet procedurale kushtetuese të ngritura sa i përket procedurës së miratimit të ligjeve (jo edhe përmbajtjes së tyre), nuk pengojnë procesin e rëndësishëm të vlerësimit të paraaplikimit, presim që Kosova t’i marrë edhe vlerësimet rreth nivelit të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe teknike për

anëtarësim në SEPA. Hyrja në fuqi e ligjeve dhe rregulloreve mundëson përmbylljen e këtij procesi preliminar dhe përgatitjen e aplikacionit përfundimtar. Ky hap mundëson që DG FISMA të ofrojë një vlerësim të plotë, me komentet dhe rekomandimet e mundshme, para se të dorëzohet aplikacioni i finalizuar te Këshilli Evropian i Pagesave (EPC), ndërsa një vendim përfundimtar për anëtarësimin e Kosovës në SEPA mund të

pritet vitin e ardhshëm, si pjesë e iniciativës më të gjerë të integritimit të Ballkanit Perëndimor, nëse nuk paraqiten vonesa që ndikojnë ecurinë e këtij procesi. BQK shpreh mirënjohjen për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme nga Komisioni Evropian, Banka Botërore dhe partnerë të tjerë për arritjen e dorëzimit të paraaplikimit. Njëkohësisht, BQK shpreh falënderimin për institucionet e Republikës së Kosovës për kontributin dhe mbështetjen gjatë procesit të para-aplikimit, duke shprehur besimin në angazhimin e vazhdueshëm që procesi i ligjeve relevante të qartësohet sa më shpejt që të jetë e mundur, marrë parasysh rëndësinë e anëtarësimit në SEPA dhe përfitimeve të gjithanshme prej saj. Integrimi në SEPA pritët të sjellë përfitime të konsiderueshme ekonomike dhe financiare ku, përveç aspekteve të tjera integruese, qytetarëve dhe bizneseve pritët t’ju sjellë një kursim vjetor rreth 55 milionë euro nga tarifat për transferet ndërkombëtare, të vlerësuar nga Grupi i Ekspertëve Gjermanë (GET).



Hill: ShBA-ja nuk sheh prova që e lidhin Beogradin me sulmin në Ibër-Lepenc

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Serbi, Christopher Hill, tha se ShBA-ja "nuk sheh asnjë provë që do të çonte në Beograd" kur bëhet fjalë për atë se kush qëndron pas sulmit në kanal in e furnizimit me ujë, Ibër-Lepenc, në veri të Kosovës. "Ne sigurisht nuk shohim asnjë provë që do të çonte në Beograd, por dikush e bëri atë dhe duhet të kryhet një hetim i plotë", tha Hill në një intervistë për televizionin publik të Serbisë, RTS.

Në veri të Kosovës të banuar me shumicë serbe, në Zubin Potok, më 29 nëntor ka ndodhur një shpërthim, i cili ka dëmtuar kanal in e Ibër-Lepencit, i cili furnizon me ujë disa qytete, si dhe Korporatën Energjetike të Kosovës për ftohjen e termocentraleve.

Hill shtoi se është mirë që Byroja Federale e Hetimeve e ShBA-së (FBI) po e mbështet hetimin dhe se kjo flet për mungesën e besimit dhe një "prirje drejt akuzave të ndërsjella".

Policia e Kosovës ka bërë me dije se sulmi është kryer deri me 20 kilogramë eksploziv. Kosova fajsoi Serbinë për këtë sulm, por Beogradi zyrtar e hodhi poshtë një gjë të tillë.

Në ditët pas sulmit, autoritetet e Kosovës kryen disa aksione në veri, gjatë të cilave konfiskuan

armë, municione dhe pajisje të tjera ushtarake. Nga dhjetë të shoqëruar në polici si të dyshuar për përfshirje në sulm, dy u dërguan në paraburgim për një muaj. Për autoritetet e Kosovës ky ka qenë sulmi më i rëndë në infrastrukturën kritike të vendit që nga lufta e viteve 1998/'99, dhe që dëmet shkojnë në rreth 400 000 euro. Sulmi u dënua ashpër nga ShBA-ja dhe shtetet e Bashkimit Evropian.

Nuk ka paralajmërime për sanksione ndaj industrisë së naftës së Serbisë

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Serbi, Christopher Hill, deklaroi se nuk ka ndonjë paralajmërim për vendosjen e sanksioneve ndaj Industrisë së Naftës së Serbisë (NIS) për shkak të pronësisë ruse. Ai tha për RTS-në se ekziston shqetësimi nëse NIS, në duart e rusëve, në ndonjë mënyrë ndihmon financimin e luftës në Ukrainë dhe se këto janë çështje legjitime që duhet të shqyrtohen me kujdes. "Mund t'ju them se, që kur rusët e blenë NIS-in, ka pasur një shqetësim të madh në lidhje me këtë, pasi është e vetmja rafineri në Serbi dhe që prej kohës kur është nën pronësinë shumicë të rusëve, kjo ka shqetësuar



shumë njerëz për vite me radhë. Ky shqetësim është bërë edhe më i madh për shkak të faktit se Rusia vazhdon të zhvillojë një luftë barbare kundër Ukrainës", tha Hilli.

NIS-i është që nga viti 2008 në pronësi shumicë të kompanisë shtetërore ruse "Gazprom Neft" dhe kompanisë amë të saj "Gazprom".

Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja e kanë vendosur "Gazprom Neft"-in në listën e zezë që nga viti 2014, pas aneksimit rus të gadishullit ukrainas të Krimesë. "Do të shohim se cili do të jetë rezultati. Dua t'ju siguroj se, në asnjë mënyrë, vendimi përfundimtar nuk do të ndikojë në ekonominë serbe", shtoi Hilli.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, deklaroi më 13 dhjetor se ShBA-ja planifikon të vendosë sanksione kundër NIS-it për shkak të pronësisë ruse dhe se këtyre sanksioneve do t'u bashkohet edhe Mbretëria e Bashkuar.

Një ditë më vonë, Vuçiqi tha se ende nuk ka parë një dokument zyrtar për vendosjen e sanksioneve nga ShBA-ja kundër NIS-it, por ekziston "një lloj konfirmimi zyrtar" që vendimi do të hyjë në fuqi më 1 janar për shkak të pronësisë ruse.

Departamenti i Shtetit më 16 dhjetor, në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, deklaroi se Shtetet e Bashkuara nuk publikojnë veprime të lidhura me

sanksionet.

Në përgjigje thuhet se ShBA-ja "mbetet e përkushtuar për t'i penguar të ardhurat dhe rrjetet e furnizimit dhe financimit të Rusisë që përdoren për ta mbështetur luftën e saj kundër Ukrainës".

Beogradi, që nga fillimi i pushtimit rus të Ukrainës, refuzon t'u bashkohet sanksioneve perëndimore kundër Moskës dhe vazhdon t'i ruajë lidhjet me zyrtarët në Kremlin.

Serbia është kryesisht e varur nga Rusia në sektorin energjetik, megjithëse ka nisur diversifikimin e rrugëve dhe burimeve për furnizimin me gaz.

Musku konfirmon funksionalizimin e Starlink-ut në Kosovë - çfarë do të thotë kjo?

Prishtinë, 23 dhjetor - Miliarderi amerikan Elon Musk ka njoftuar se rrjeti i tij privat satelitor i internetit, Starlink, është funksional tani edhe në territorin e Kosovës.

Musku, pronari i kompanisë hapësinore amerikane "SpaceX", shkroi në "X": "Starlink tani edhe në Kosovë". Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha të dielën se ardhja e Starlink-ut është një hap i rëndësishëm për avancimin e infrastrukturës digjitale në vend.

"Starlink është dëshmuar jashtëzakonisht i rëndësishëm në mundësimin e komunikimit kritik gjatë fatkeqësive natyrore ose rasteve të tjera të emergjencave kombëtare", tha ai në "Facebook".

Në tetor, Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) në Kosovë njoftoi se e kishte autorizuar kompaninë amerikane Starlink për ofrimin e qasjes në internet në çdo lokacion të Kosovës.

Çfarë do të thotë kjo?

Me Starlink-un Kosova do të përfitojë internet pa ndërprerje

në çdo cep të territorit edhe në situata të jashtëzakonshme. Starlink-u i ka rreth 6 000 satelitë, të cilët gjenden rreth 500 kilometra mbi Tokë, në orbitën e ulët të planetit.

Kjo do të thotë se ata janë rreth 65 herë më afër Tokës sesa satelitët tradicionalë të palëvizshëm dhe, për dallim prej këtyre të fundit, satelitët e Starlink-ut janë vazhdimisht në lëvizje dhe sigurojnë që vonesat në komunikim të jenë 10 herë më të vogla.

Anëtarja e bordit të ARKEP-it, Rrezarta Duraku Rizaj, kishte thënë në nëntor për "Radion Evropa e Lirë" se leja për operim për Starlink-un ishte hap i rëndësishëm për avancimin e infrastrukturës digjitale në Kosovë. "Autorizimi i Starlink-ut ka më së shumti impakt në rritjen e sigurisë nacionale, sidomos në periudhë konfliktesh, për faktin se pjesa më e madhe e infrastrukturës së Starlink-ut gjendet në hapësirë dhe është e paprekshme nga dëmtimet e mundshme në kohë lufte apo katastrofash natyrore në Tokë", ka thënë Duraku - Rizaj.

Ajo beson se kjo përparësi



mund të shfrytëzohet nga bizneset dhe nga institucionet qeveritare, sidomos ato të sigurisë të cilat menaxhojnë infrastrukturë kritike.

Si funksionon?

Porositjen e shërbimeve do të mund ta bëjë secili në faqen e Starlink-ut, duke kërkuar adresën më të afërt. Pas porosisë, Starlinku do t'ia dërgojë klientit pajisjen marrëse, e cila lidhet me satelitët në hapësirë. Rrezarta Duraku Rizaj tregoi asokohe se marrësi i përdoruesit është i vogël,

portativ dhe mund të përdoret në lokacione të ndryshme si, për shembull, në mal, në terrene të vështira, e vende të tjera ku nuk ka qasje të mirë në internet.

Përcaktimi i çmimeve do të bëhet varësisht prej fuqisë blerëse lokale të secilit shtet. "Tarifimi përbëhet nga dy komponentë: blerja e harduerit në fillim, terminali me pajisjet përcjellëse që blihen një herë, dhe një tarifë mujore që do të varet nga planet e shërbimit që janë të disponueshme në faqen e internetit", tregoi ajo. Shpejtësia e internetit që ofron Starlink-u është 120 deri në 250

megabajt për sekondë (mbps), varësisht se a bëhet fjalë për plane individuale apo për biznese.

Operatorët në Kosovë aktualisht mundësojnë internet më të shpejtë. Ekonomive familjare u ofrohet internet deri në 500 mbps në kuadër të pakove të kombinuara me shërbime televizive, me çmime deri në 35 euro.

Sipërmarrësi Darsej Rizaj, bashkëthemelues i Shkollës Digjitale dhe i kompanisë "Starlabs", e pranon që sa i përket shpejtësisë, Starlink-u nuk u bënë konkurrencë operatorëve lokalë, por është plan i mirë rezervë në rast të dështimit të linjave tokësore.

Starlink-u pati marrë gjithë vëmendjen në shkurt të vitit 2022, kur Rusia nisi luftën në Ukrainë dhe, për pasojë, ukrainasve iu shkëputen linjat e internetit. Vendimi i Muskut për ta mbuluar Ukrainën me internet ishte konsideruar jetik për shumë operacione të ushtrisë ukrainase, por edhe për rimëkëmbje të infrastrukturës së energjisë dhe komunikimit.

Haxhiu godet Prokurorinë Speciale: Gjithmonë ka dashur ta dëmtojë Vetëvendosjen

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka folur të hënën për ftesën që Prokuroria Speciale i ka bërë për intervistim kryeministrit Albin Kurti. Ajo ka thënë prokurorët nuk duhet ta refuzojnë kërkesën e Kurtit që ai të intervistohet në zyrën e tij. "Prokurorët nuk duhet ta refuzojnë ftesën e

Kurtit, intervistimi në zyrën e kryeministrit ka ndodhur edhe më herët, por këta nuk duan të flasin për këtë. Arsyet duhet të tregohen nga vetë Prokuroria", ka thënë Haxhiu.

Ajo ka theksuar se nëse Prokuroria Speciale është e interesuar ta marrë përgjigjen nga kryeministri Kurti, atëherë lirisht mund t'i

përgjigjet kërkesës së kryeministrit Kurti. Po ashtu, Haxhiu ka thënë se Prokuroria Speciale ka mundur më herët ta dërgojë ftesën, jo në kohë fushate. "Prokuroria Speciale ka tendencë ta dëmtojë VV-në. Gjithmonë kanë qenë bashkë kur kanë dashur që VV-në ta shpallin organizatë terroriste", ka thënë Haxhiu.



Ngrihet aktakuzë në mungesë për krime lufte në Kosovë

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar të hënën se ka ngritur aktakuzë kundër një të dyshuari me iniciale V. N. për krime lufte kundër popullsisë civile në Kosovë më 1998-1999. Sipas aktakuzës, V. N. dyshohet për vrasjen e personave M. A. dhe Sh. A. si dhe plagosjen e Sh. S.

Vepra dyshohet se është kryer në qytetin e Suharekës gjatë viteve 1998-1999, së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave policore dhe ushtarake serbe. Për shkak se i pandehuri V. N. është i paarritshëm për organet e drejtësisë, Prokuroria thotë se janë "plotësuar kushtet ligjore për ngritjen e aktakuzës në mungesë". Kjo çështje penale tashmë i ka kaluar në kompetencë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kjo është aktakuza e dytë për krime lufte në mungesë e ngritur gjatë muajit dhjetor.

Ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu, në një konferencë për medie në lidhje drejtësinë tranzicionale, më 23 dhjetor, tha se deri më tani janë të ngritura 67 aktakuza nga Departamenti për Krime Lufte në Prokurori. "(Aktakuzat janë të ngritura) në 62 raste ndaj 174 personave. 10 raste janë duke u gjykuar në mungesë dhe ky numër pritet të rritet në vazhdimësi", tha Haxhiu.

Më tutje Haxhiu tha se gjykimet në mungesë kanë qenë të rëndësishme "duke pasur parasysh që Serbia nuk i dorëzon kriminelët e luftës". Gjykimi i parë në mungesë për krime lufte pati nisur në nëntor të vitit 2023 në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjykimi mund të mbahet në mungesë të të akuzuarit dhe kjo mund të bëhet kur prokuroria dhe gjykata t'i kenë shterur të gjitha mjetet për sigurimin e pranisë së të



akuzuarit.

Dhjetorin e kaluar Prokuroria Speciale e Kosovës kishte thënë se ka ngritur gjithsej 33 aktakuza, që përfshijnë 89 persona për krime lufte në Kosovë.

Prej përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, rreth 70 persona janë dënuar për krime lufte para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Nga viti 2000 deri në vitin 2008 krimet e luftës në Kosovë janë hetuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008 prej Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX). Në vitin 2018 ky mision i ka dorëzuar lëndët në Prokurorinë e Kosovës dhe në gjykatat vendore.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-1999 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Më shumë se 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur - pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Çeku: Serbia gjatë luftës së fundit në Kosovë ka shkatërruar mbi 1 800 monumente e 1.7 milion libra shqip



PRISHTINË, 23 DHJETOR - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrullah Çeku, kanë mbajtur të hënën konferencë për medie. Në fjalën e tij para medieve, Çeku ka njoftuar se në kuadër të qeverisë është themeluar edhe një grup punues për dokumentimin e shkatërrimit të qëllimshëm të trashëgimisë kulturore. "Kemi krijuar grup punues për

dokumentimin e shkatërrimit të qëllimshëm të trashëgimisë kulturore gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ky grup ka përfunduar një raport. Në raport është konstatuar se gjatë luftës në mënyrë të qëllimshme Serbia ka shkatërruar afro 1 800 monumente të trashëgimisë kulturore", ka thënë Çeku. Më tej ai ka thënë se Serbia, po ashtu, ka grabitur mbi 3 700 artefakte, 175 biblioteka

publike, duke bërë me dije se janë shkatërruar edhe 1.7 milion libra shqip. Ai ka theksuar se është në fazën e hartimit projekti i Muzeut të Burgut të Prishtinës. "Ne kemi votuar edhe për krijimin e Muzeut të Gjenocidit dhe Përpjekjes për Liri. Jemi në fazën e hartimit të projektit të Muzeut të Burgut të Prishtinës dhe ndërtimit të memorialit për fëmijët e vrarë gjatë luftës", ka deklaruar Çeku.

Vitia nënshkruan listën për çmimet e unifikuara të barnave, ulje për mbi 2 900 produkte mjekësore

Prishtinë, 23 dhjetor - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se ka nënshkruar listën finale për çmimet e unifikuara të barnave. Ai ka

shkruar në "Facebook" se në disa nga barnat, çmimet janë ulur 5 deri në 10 herë. "Sot nënshkrua listën finale që i hap udhë jetësimit të Ligjit për

çmimet e unifikuara të Barnave. Për herë të parë, barnat do të jenë me çmime të njëjta kudo dhe më të ulëta sesa tani. Në disa nga barnat, çmimet

janë ulur 5 deri në 10 herë. Ulje të ndjeshme ka në mbi 2 900 produkte medicinale. Urime të gjithë qytetarëve!", ka shkruar Vitia.



Qeveria ua ndan nga 100 euro pensionistëve dhe fëmijëve deri në 16 vjeç

EPOKA
ERE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njoftoi se qeveria ka vendosur t'ua ndajë nga 100 euro shtesë për fundvit të gjithë pensionistëve dhe fëmijëve deri në 16 vjeç. Megjithatë, ai u kritikua nga opozita e disa analistë se e bëri këtë për qëllime të fushatës zgjedhore. Ministri i Financave, Hekuran Murati, në një konferencë të përbashkët me Kurtin, tha se gjatë javës që vjen do të punohet për ekzekutimin e tyre. Ai shtoi se pensionistët dhe fëmijët nuk kanë nevojë të aplikojnë për shtesën për fundvit, pasi ata janë tashmë të regjistruar në sistemin e pensioneve dhe skemave të shtesave për fëmijë. Kosova do të mbajë zgjedhje parlamentare më 9 shkurt dhe ish-ministria e Financave dhe tani deputete e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LD), Hykmete Bajrami, tha se "shpërndarja" e buxhetit të shtetit në kohë fushate është "skemë e korrupsionit publik". Anëtari i kryesisë së Partisë

Demokratike të Kosovës (PDK), Arben Mustafa, theksoi se qeveria ndërmoi veprimin për shtesat prej 100 eurove "si përpjekje për ta mbuluar dështimin katërvjeçar".

Anëtari i ri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Haki Abazi, e kritikoi kryeministrin se po e bën këtë për fushatë zgjedhore dhe për fitim votash.

Kurti ndërmoi një sërë hapash për t'i rritur pagat dhe pensionet në muajt e fundit.

Pas vendimit për rritje për 20 për qind në tetor, pensionet në Kosovë tani janë nga 120 deri në 318 euro

Edhe për Naim Jakaj, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), vendimi i Kurtit për pagesën shtesë prej 100 eurove duket "më shumë si një shpërndarje e parave në kohë fushate sesa një masë e bazuar në analizë dhe targetim social". "Transferi prej 100 eurosh për pensionistët dhe fëmijët është një ndihmë e përkohshme, por nuk përbën një politikë publike të mirëfilltë dhe të qëndrueshme", tha Jakaj për Radion Evropa e Lirë. Ai e kritikoi Kurtin për



dështimin e përcaktimit të kriterëve të qarta për targetimin social gjatë katër vjetëve të mandatit të saj, i cili i mbaron në fillim të vitit 2025. "Për shembull, transferet financiare për fëmijët trajtohen në mënyrë të njëjtë si për një familje kosovare me të ardhura të mëdha, ashtu edhe për një punëtor/e që merr pagë 500 euro, apo një rast social që pranon 70 deri në 210 euro në muaj", tha ai.

Qeveria e Kosovës në vitin 2021 nxori një skemë për t'i paguar

fëmijët nën moshën 16-vjeçare në baza mujore fillimisht me nga 10 euro dhe 20 euro në muaj për fëmijë.

Kurti e paraqiti një skemë të re për pagesat për fëmijë në gusht të këtij viti me një rritje të vogël. Sipas skemës së re, fëmija i parë dhe i dytë në familje paguhet nga 20 € në muaj secili, ndërsa për nënat që kanë tre fëmijë e më shumë, secili prej tre fëmijëve paguhet nga 30 euro.

Një skemë e tillë nuk i merr parasysh nevojat specifike të grupeve më të cenueshme dhe

kontribuon në shpërndarjen e pabarabartë të burimeve publike, sipas Jakajt.

Jakaj tha se qeveria ka dështuar t'i harmonizojë pensionet me koston e jetesës, duke i lënë pensionistët "në vështirësi të mëdha ekonomike". "Për më tepër, edhe shtesat prej 100 eurosh janë të pamjaftueshme për t'i përmbushur nevojat bazë të kësaj kategorie", shtoi Jakaj.

Edhe Shenoll Muharremi, ekonomist dhe njohës i politikave publike, e quajti vendimin e qeverisë "korrupsion të pastër elektoral" dhe përpjekje për "të blerë vota" në prag të zgjedhjeve.

Vendimi i Kurtit për t'i rritur pagat për sektorin publik në fund të tetorit ishte parë si fushatë zgjedhore.

Qeveria e Kurtit nuk është e vetmja që ka rritur pagat në prag zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, megjithatë vetë Kurti kishte shprehur kritika ndaj një praktike të tillë. Për shembull, kryeministri i atëhershëm nga PDK-ja, Hashim Thaçi, i kishte rritur pagat për sektorin publik në mars 2014, rreth tre muaj para mbajtjes së zgjedhjeve atë vit.

Thirrje për transparencë dhe llogaridhënie nga Termokos-i dhe ZRRE-ja në lidhje me faturimin e energjisë termike

Prishtinë, 23 dhjetor - Iniciativa CorrWatch shpreh shqetësimin e thellë për faturimin e energjisë termike nga Termokos-i dhe kërkon një rishikim të menjëhershëm pas publikimit të faturave të tetorit dhe nëntorit.

Përmes një reagimi për medie thuhet se këto fatura janë konsideruar të fryra dhe të shpërputhura me standardet e mbrojtjes së konsumatorëve, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në besimin e qytetarëve dhe në integritetin e procesit rregullativ në sektorin e ngrohjes termike. "Një nga çështjet më shqetësuese është se faturat janë lëshuar pa miratimin e tarifave nga ZRRE. Në mënyrë të papranueshme, Termokos-i ka aplikuar komponentin e ndryshueshme (tarifa për furnizim/konsum), e cila është për konsumatorët që



kanë matës të ngrohjes, ndonëse shumë banesa ende nuk kanë matës. Kjo ka sjellë ankesa të shumta nga qytetarët, të cilët po përballen me rritje të papritur të faturave prej rreth 30 %, pa një njoftim zyrtar që të njoftonte shtrenjtim tarifash për vitin 2024. Për më tepër,

Termokos-i ka vendosur dy kategori të reja kostosh, për konsum të përbashkët dhe kapacitet termik, pa ofruar një sqarim të qartë mbi metodologjinë ose arsyetimin pas këtyre ndryshimeve. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e

Konsumatorit, që kërkon informimin e saktë dhe transparent të qytetarëve për çdo tarifë dhe ndryshim që lidhet me shërbimin", thuhet në reagim.

Tutje në reagim bëhet me dije se kjo situatë ka krijuar një valë ankesash nga konsumatorët, të cilët ndihen të ngarkuar me kosto të paarsyeshme dhe të pajustificuara. "ZRRE, si autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve dhe monitorimin e tarifave, duhet të ndërhyjë urgjentisht për të adresuar këto çështje dhe për të siguruar që: Nëse ka pasur rritje tarifash, të shpjegohen arsyet dhe bazat përkatëse; Komponenti i ndryshueshëm të hiqet nga faturat për ata që nuk kanë matës, pasi nuk ka bazë ligjore për aplikimin e saj; Faturat e tetorit dhe nëntorit të pasqyrojnë tarifën e vitit të kaluar,

pasi ato janë shpërndarë pa miratimin e tarifave përkatëse; Kostoja e tepërt që është aplikuar në këto muaj të zbritet në faturat e dhjetorit", thuhet në njoftim.

Informimi i duhur, transparenca dhe llogaridhënia janë kyçe për ta rikthyer besimin e konsumatorëve dhe për të mbrojtur integritetin e procesit rregullativ dhe të operatorit të energjisë termike. Fatura të rritura e të papërbalueshme të ngrohjes nënkuptojnë edhe ulje të cilësisë së jetës së qytetarëve, por edhe rritje të konsumit nga energjia elektrike, çka nuk i kontribuon fazës së tanishme të tranzicionit energjetik në të cilin ndodhet Kosova.

CorrWatch i bën thirrje Termokos-it ta kryejë detyrimin ligjor për shërbim të drejtë e cilësor për konsumatorët dhe ZRRE-së që të ndërhyjë sa herë që të drejtat e tyre shkelen.

DhTIK përfundon me sukses vitin 2024, u jep mirënjohje bizneseve anëtare

Prishtinë, 23 dhjetor - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë dhe Industrisë Kosovë mbledhi institucione, partnerë dhe miq nga vendi, rajoni e bota, për ta shënuar përmbylljen e vitit 2024. Kryetari i saj, Skender Krasniqi, ka thënë se edhe ky vit ishte me shumë aktivitete që Dhoma e

Tregtisë dhe Industrisë i ka pasur me të gjithë, përfshirë institucionet në nivel qendror dhe lokal, dhe bizneset.

Ai ka përmendur takimet e shumta me institucionet, organizimin e "Kafes së mëngjesit" me shumë komuna e biznese, takime me organizata të

ndryshme shtetërore vendore dhe të huaja, me qëllim të zgjidhjes dhe avancimit të ligjeve, për një klimë më të mirë për të bërë biznes.

Në shenjë falënderimi për mbështetjen dhe bashkëpunimin, DhTIK u ka dhënë mirënjohje të gjitha bizneseve anëtare.



Kërcënon Trump: Do rimarrim kontrollin e Kanalit të Panamasë



Presidenti i zgjedhur Donald Trump kërcënoi të rikthejë kontrollin e SHBA mbi Kanalin e Panamasë, duke akuzuar Panamanë për tarifa të tepruara, për përdorimin e këtij kalimi ujor në Amerikën Qendrore, që u mundëson anijeve të kalojnë mes Oqeanit Paqësor dhe Atlantik.

Gjatë një fjalimi për mbështetësit në Arizona të dielën, Trump tha se nuk do të lejojë që kanali të bjerë në "duar të gabuara," duke paralajmëruar për ndikimin e mundshëm kinez.

Kina nuk ka kontroll mbi kanalin, por një filial i CK Hutchison Holdings me bazë në Hong Kong ka administruar prej kohësh dy porte në hyrjet e kanalit, nga Karaibet dhe Paqësori.

Deklaratat e Trump erdhën disa orë pasi ai bëri një kërcënim të

ngjashëm kundër Panamasë në një postim në Truth Social të shtunën në mbrëmje.

"A ka dëgjuar ndokush për Kanalin e Panamasë?" tha Trump të dielën në AmericaFest, një ngjarje e përvitshme e organizuar nga Turning Point, një grup konservator aleat. "Sepse po na grabisin në Kanali i Panamasë, ashtu siç na grabisin kudo tjetër."

Kërcënim i paprecedentë

Komentet e Trumpit përbëjnë një shembull jashtëzakonisht të rrallë të një lideri amerikan që sugjeron presion ndaj një shteti sovran për t'i dorëzuar territorin. Kjo gjithashtu tregon një ndryshim të mundshëm në diplomacinë amerikane me Trumpin, i cili nuk ka shmangur më parë kërcënimet dhe

retorikën agresive në marrëdhëniet ndërkombëtare.

"Tarifat që po ngarkohen nga Panamaja janë qesharake, shumë të padrejta," tha Trump. "I ishte dhënë Panamasë dhe popullit të saj, por me kushte. Duhet të na trajtoni në mënyrë të drejtë, dhe ata nuk na kanë trajtuar drejt. Nëse parimet morale dhe ligjore të këtij gjesti madhështor nuk zbatohen, atëherë ne do të kërkojmë që Kanali i Panamasë të na kthehet plotësisht, shpejt dhe pa shumë pyetjesh."

Reagime nga Panamaja

Ambasada e Panamasë në Uashington nuk komentoi për kërcënimet e Trumpit. Megjithatë, disa politikanë panamezë reagueshan fuqishëm në rrjetet sociale, duke kërkuar nga

qeveria të mbrojë autonominë e kanalit.

"Qeveria ka detyrën të mbrojë autonominë tonë si një vend i pavarur," shkroi Grace Hernandez, një deputete nga partia opozitare MOCA, në një postim në platformën X pas deklaratave të Trumpit.

Historia e kanalit

Shtetet e Bashkuara ndërtuan dhe administruan Kanalin e Panamasë për disa dekada. Por dy marrëveshje të firmosura në vitin 1977 midis SHBA dhe Panamasë hapën rrugën për kthimin e plotë të kontrollit te Panamaja në vitin 1999, pas një periudhe administrimi të përbashkët.

Kanali, që lejon deri në 14,000 anije të kalojnë çdo vit, përbën 2.5% të tregtisë detare globale


dhe është thelbësor për importet amerikane nga Azia dhe eksportet e gazit të lëngshëm natyror.

Çfarë mund të ndodhë?

Nuk është e qartë si Trump do të përpiqet të rikthejë kontrollin mbi kanalin, dhe ai nuk do të kishte mbështetje ligjore ndërkombëtare për këtë gjë.

Kjo nuk është hera e parë që Trump shpreh interes për zgjerim territorial. Gjatë mandatit të tij të parë, ai sugjeroi blerjen e Groenlandës nga Danimarka, por kjo u refuzua publikisht nga autoritetet daneze. Kohët e fundit, ai ka përmendur idenë për ta kthyer Kanadanë në një shtet amerikan, megjithëse serioziteti i kësaj deklaratë mbetet i paqartë. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON Inveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Rama, Zhegrovës: Talentët si ju na bëjnë krenarë

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Edon Zhegrova, është takuar të hënën me kryetarin e komunës së Prishtinës, Përparim Rama. Bashkë me

Zhegrovën, tek i pari i kryeqytetit ishte edhe presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. Me këtë rast, yllit të Lilles, Rama ia ka dorëzuar "Hyjneshën në fron", derisa ka

thënë se Zhegrova po e bën krenare Kosovën me paraqitjet në Evropë. "Fillova ditën me lojtarin e vitit, Edon Zhegrova. Talentet si ai na bëjnë krenarë, duke përfaqësuar vendin tonë me dinjitet në skenën

ndërkombëtare. Kryeqyteti gjithmonë mbështet kampionët e saj", ka shkruar Rama në "Facebook". Zhegrova momentalisht është një nga futbollistët më të mirë në Evropë. Atë po e kërkojnë



disa klube të mëdha evropiane.

Llapi ndahet me Avdylin: Ishte kyç në sukseset e klubit

Llapi i Tahir Batatinës vazhdon ndryshimet në skuadër pas përfundimit të sezonit vjeshtor. Fillimisht shkarkoi stafin e trajnerëve në përjashtim të Batatinës, kurse të hënën ndau rrugët me portierin Ilir Avdyli. "Gjatë tri viteve e gjysmë Iliri ka qenë një figurë kyçe në skuadrën tonë, duke dhënë gjithmonë maksimumin e tij në fushë dhe jashtë saj", thuhet në njoftimin e Llapit



gjithmonë të paharrueshme", thuhet në njoftimin e Llapit. Skuadra e drejtuar nga trajneri Tahir Batatina e ka falënderuar portierin për dashurinë që ka treguar për fanellën e klubit nga Podujeva. "142 ndeshje, 48 prej tyre pa pranuar gol, shumë pritje vendimtare të tij, një Kupë e Kosovës dhe një Superkupë, janë pjesë e statistikave të jashtëzakonshme të tij që ndihmuan klubin në sukseset e arritura. Faleminderit Ilir për çdo pritje, për çdo moment të veçantë dhe për dashurinë që ke treguar ndaj fanellës sonë. KF Llapi të uron nga zemra suksese të mëdha në kapitullin tënd të ardhshëm!", thuhet në njoftim. Largim nga Llapi e ka konfirmuar edhe portieri Ilir Avdyli në "Facebook". Ai i ka falënderuar të gjithë në klub për mbështetjen që i kanë

dhënë përgjatë gjithë kohës. "Shfrytëzoj rastin ta falënderoj presidentin e klubit Beqir Batatina për korrektësinë, kryetRAINERIN Tahir Batatina dhe ndihmësit e tij për besimin që më kanë dhënë gjatë gjithë kësaj kohe. Falënderim i veçantë u takon edhe bashkëlojtarëve me të cilët ndava këtë rrugëtim të bukur, si dhe tifozëve të klubit 'Legjendat' për mbështetjen maksimale gjatë këtyre viteve. KF Llapi i dëshiroj suksese në të ardhmen", ka shkruar Avdyli. Në fundjavë skuadra e Llapit ka shkarkuar stafin e trajnerëve. Vendimi ka ardhur pas rezultateve të dobëta të kësaj skuadre në stinorin vjeshtor në elitën e futbollit të Kosovës. Llapi në 11 ndeshjet e fundit nuk ka fituar, derisa sezonin e mbylli në vendin e nëntë me vetëm 18 pikë nga 18 ndeshje.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Skuadra e Llapit ka konfirmuar se portieri Ilir Avdyli nuk do të jetë më pjesë e skuadrës. Klubi llapjan e ka vlerësuar Avdylin si figurë kyçe në suksesin e skuadrës. "KF Llapi njofton se pas një periudhe të jashtëzakonshme bashkëpunimi, portieri ynë Ilir Avdyli, me marrëveshje, ka përfunduar aventurën e tij me klubin tonë. Gjatë tri viteve e

gjysmë Iliri ka qenë një figurë kyçe në skuadrën tonë, duke dhënë gjithmonë maksimumin e tij në fushë dhe jashtë saj. Profesionalizmi, përkushtimi dhe pasioni që ai tregoi gjatë këtyre viteve do të mbeten gjithmonë pjesë e historisë së klubit tonë. Gjatë kohës së tij me KF Llapi, ai ka qenë lider i vërtetë dhe shembull frymëzues për të gjithë. Arritjet e përbashkëta dhe kujtimet që kemi ndarë së bashku do të mbeten

Broja, 'Ylli i javës' në Superligë

GJILAN, 23 DHJETOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 18 në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të FC Drita, Ron Broja. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e tetëmbëdhjetë t'i takojë Ron Brojës, i cili shënoi golin e barazimit dhe asistoi në golin e fitores për

ekipin e tij në ndeshjen kundër FC Feronikeli 74, që përfundoi me rezultatin 2:1. Kapitani Broja gjatë tërë ndeshjes, ashtu si edhe gjatë tërë këtij stinori, ka treguar një karakter të lartë, duke e udhëhequr skuadrën e tij drejt kreut të tabelës. Aktualisht skuadra e Brojës ndodhet në pozitën e para tabelore, me gjithsej 40 pikë të grumbulluara. Pasi mori këtë çmim, Broja u shpreh i lumtur që u vlerësua si më i miri i javës: "Ky stinor për ne ka qenë mjaft pozitiv, por edhe i



vështirë. Megjithatë, jemi në vendin e parë me një diferencë të mirë pikësh. Që nga ndeshjet e Evropës kemi

punuar shumë dhe besoj se me plot merita jemi këtu ku jemi. Jemi të vetëdijshëm që në dy fazat e ardhshme na pret një punë e vështirë për ta mbajtur pozitën e parë. Për mua është nder dhe privilegj të jem kapiten i FC Dritës, ku dihet që presioni është shumë i madh, sepse çdo vit luajmë për trofe, mirëpo mendohej që, bashkë me gjithë ekipin, t'i arrijmë synimet tona me shumë punë". "E kemi përgatitur ndeshjen shumë mirë, sepse dihet forma e lartë e Feronikelit 74 në ndeshjet e

fundit dhe goli i parë që pranuar në minutat e para të ndeshjes na vështirësoi punën, sepse gjithmonë është më vështirë ta rikthesh rezultatin. Por treguam karakter të lartë, dhe e gjithë ekipi dha maksimumin, çka na u shpërblye me tri pikë të reja për skuadrën tonë. Falënderoj Federatën e Futbollit të Kosovës që më shpallën 'Yllin e javës', bashkëlojtarët dhe stafin e klubit Drita, sepse pa ta nuk do të ishte e mundur", ka deklaruar Broja për faqen zyrtare të FFK-së.

FC Suhareka: Fituam një superyll, Eurolind Avdimetajn

Suharekë, 23 dhjetor - FC Suhareka e mbylli sezonin vjeshtor me humbje, pasi është mposhtur Ballkani me rezultat 0-2. Skuadra që garon për herë të parë në Superligë është shprehur e lumtur që edhe përkundër humbjes, ka fituar edhe një yll. Në fakt, në këtë ndeshje debutoi

Eurolind Avdimetaj. "Në xhiron përmbyllëse të stinorit vjeshtor zhvilluam ndeshjen e derbit lokal ndaj skuadrës së Ballkanit ku, për fat të keq, pësua humbje, por fituam një super yll të futbollit ku me një debutim ëndrrash e përjeto portieri ynë 19-vjeçar Eurolind Avdimetaj.

Përkundër disfatës paraqitja e Avdimetajt ishte e jashtëzakonshme prej 7 goditjeve në portë 5 pritje të 100 % për gol e me shumë dalje të suksesshme ishin statistikat që pati gardiani ynë i ri i portës. Me një potencial shumë të madh rruga drejt majave është e

hapur një fillim i shkëlqyer për një karrierë premtuese, vazhdo të shkëlqesh dhe t'i përmbushësh ëndrrat e tua në fushën e blertë përkrahja jonë dhe e shokëve të skuadrës do të vazhdojë të jetë edhe më e madhe në vazhdim", thuhet në postimin e Ballkanit.



Denveri fiton në shtesë, triumfojnë edhe Indiana e Houstoni

Denver, 23 dhjetor - Ekipi i Denverit fitoi me rezultat 132-129 pas kohës shtesë ndaj New Orleansit, duke arritur një fitore të rëndësishme që e afron me zonën e ekipeve më të mira në Perëndim. Nikola Jokiq

realizoi sërish një "triple double", 27 pikë, 13 rebounde e 10 asistime, lider në fushë për Denverin. Ai u mbështet edhe nga Jamal Murray po me 37 pikë e Russell Westbrook me 21 pikë. Për vendësit, dyshja Hawkins - McCollum

realizoi 49 pikë, por që nuk mjaftuan për ta shmangur humbjen. Skuadra e Indianas, falë një lojë të mirë kolektive, ku shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë, mundi me shifrat 122-95 Sacramenton. Pacal Siacam me 19 pikë ishte

shënuesi më i mirë për miqtë. Jasthtë fushës fitoi edhe ekipi i Houstonit, që mundi me rezultat 114-110 Toronton, në fund të një ndeshje me shumë rivalitet. Dilion Brooks me 27 pikë e Jalen Green me 22 pikë u dalluan për teksanët.



Guardiola: Kemi thyer shumë rekorde, tani po i bëjmë në të kundërt

MANCHESTER, 23 DHJETOR - Manchester City pësoi një tjetër disfatë, kësaj here ndaj Bournemouthit, duke regjistruar humbjen e shtatë në 9 ndeshjet e fundit. Një krizë e thellë për "Citizens", që ka rrëshqitur në pjesën e poshtme të tabelës, shumë larg kreut, pas katër titujve radhazi të Premierë Ligës. Pas kësaj disfate të radhës, Pep Guardiola u shpreh kështu për kanalet zyrtare të klubit anglez: "Humbëm, tani duhet të mendojmë për Evertonin dhe jo për më shumë se kaq. Humbëm një tjetër ndeshje dhe tani duhet të mendojmë se çfarë të bëjmë, pasi kemi fituar kaq shumë. Jam këtu për të dhënë përgjigjen time, jo për t'u justifikuar e mbrojtur me mungesat e shumta, si rezultat i dëmtimeve në masë të lojtarëve. E kam thënë që kur humb kaq shumë ndeshje, duhet t'i marrësh përgjegjësitë. Futbollit është një biznes dhe duhet të fitosh". Manchester City, që dikur njihej për thyerjen e rekordeve pozitive, tani rrezikon të



kthehet në ekipin që thyen rekorde negative. Guardiola ka shpjeguar këtë fenomen: "Kjo skuadër ka qenë konsistente për një kohë të gjatë, kemi thyer çdo rekord. Tani jemi në anën tjetër dhe kjo është e vërteta. Duhet të gjejmë një mënyrë për të dalë nga kjo situatë. Jemi në këtë pozitë, ndonjëherë gjithçka bëhet më e vështirë, por lojtarët duhet të thonë: Ok, do të përpiqemi.

Në fund të fundit është vetëm një lojë. Mund të fitosh ndeshje, mund të humbasësh ndeshje, mund të mbetesh i njëjtë, mund t'i ndryshosh gjërat, por është vetëm një lojë". I pyetur për shkaqet e këtij momenti të vështirë, Guardiola u përgjigj: "Sigurisht që ka arsye të tjera. Pësojmë gola që nuk i pësonim në të kaluarën dhe nuk shënojmë gola si dikur. Futbollit nuk ka vetëm një arsye. Ka shumë faktorë të vegjël. Sezonin e kaluar fituam Premierë Ligën, sot jemi në një krizë të thellë. Duhet të mendojmë pozitivisht. Kam besim të jashtëzakonshëm te djemtë e mi. Disa prej tyre kanë një krenari të madhe dhe dëshirën e duhur për t'ia dalë. Duhet të gjejmë një mënyrë, hap pas hapi, që herët a vonë të kthehemi në rrugën e duhur". Manchester City po përballlet me një nga periudhat më të vështira në vitet e fundit, por Guardiola mbetet optimist dhe i bindur se ekipi i tij do ta rigjejë forcën për t'u rikthyer në majat e futbollit anglez.

Alonso: Ende ëndërroj titullin e tretë për pilotë

MADRID, 23 DHJETOR - Piloti spanjoll Fernando Alonso e mbylli sezonin me një fashë të dukshme në shtatull, duke u ankuar më shumë për performancën e tij sesa për pasojat fizike të shkaktuara nga drejtimi i një Aston Martin aspak i shpejtë. Megjithatë, në moshën 43-vjeçare, Fernando Alonso nuk ndalet kurrë së ëndërruari për titullin e tretë kampion bote për pilotë në Formula 1. Sidomos tani që ardhja e Adrian Newey është zyrtare në skuadrën me bazë në Silverstone. Për pasojë, makina angleze synon mundësinë për të luftuar për titullin që në sezonin 2026, kur piloti spanjoll do të jetë 45-vjeçar dhe ai, zyrtarisht,



do të jetë në vitin e fundit të kontratës. "Unë ende ëndërroj titullin e tretë për pilotë në F1. Pse nuk duhet? E di që viti 2026 mund të jetë shansi im i fundit, duke qenë se sezonin tjetër do të jetë shumë i vështirë, por unë ende ëndërroj. Formula 1 është ndoshta një sport për ëndërrimtarët, sepse gjithçka mund të ndodhë. Të shohim", ka

thënë Alonso. Duke folur për pritshmëritë, ka shtuar: "Janë të larta sepse do të kemi një makinë të re, një ndryshim në rregullore dhe Adrian do të jetë aty. Do të jetë momenti i së vërtetës, prandaj pritshmëritë janë të larta. Unë gjithmonë do të kem besim të lartë në veten time". Alonso nuk e mbron idenë të vazhdojë të garojë përtej vitit 2026: "Ditën që do të ndihem më i ngadalshëm se shoku im i skuadrës ose më i ngadalshëm sesa është e mundur me makinën që drejtoj, atëherë do të ngre duart lart dhe do të ndaloj. Nëse viti 2026 do të jetë pozitiv mund të garoj ende. Nuk do ta mbyll kurrë derën herët".

SHKURT

Babai i Neymarit: Isha kundër që ai të largohej nga Barcelona

Babai i Neymarit, Neymar Pai, ka folur për transferimin e djalit nga Barcelona te Paris Saint Germaini. Neymariu bashkua PSG-së në verën e vitit 2017, në një marrëveshje me vlerë 222 milionë euro, e cila deri më sot mbetet transferimi më i shtrenjtë në historinë e futbollit. Në atë kohë mendohej se Neymar po largohej për t'i shpëtuar hijes së Lionel Messit dhe për të bërë emër te PSG-ja. Megjithatë, duket se jo të gjithë e pranuan vendimin e Neymarit për t'u bashkuar me PSG-në dhe njëri prej tyre që ishte kundër lëvizjes ishte babai i tij. "Bordi në vitin 2017 i bëri gjërat të vështira. Me të vërtetë doja që djali im të qëndronte në Barcelonë. Deri në ditët e fundit bëmë gjithçka që ai të mos largohej dhe ai u largua", ka thënë ai. Duke shpjeguar vendimin e Neymarit për t'u bashkuar me PSG-së, ai deklaroi se sulmuesi nuk donte të hynte në këpucët e Messit. "Ai nuk donte ta vinte veten në pozicionin e yllit më të madh të Barcelonës. Dhe ai vendosi duke thënë: 'Unë po shkoj në anën time'", ka shtuar babai i Neymarit. Neymariu luajti për PSG-në për gjashtë vjet përpara se të largohej në vitin 2023. Gjatë kohës së tij në "Parc des Princes", ai u lidh me një rikthim te Barcelona në shumë raste. Neymariu aktualisht është pjesë e Al Hilalit, megjithëse kontrata e tij me skuadrën saudite skadon në fund të sezonit.

Barça e interesuar për Rashfordin

Me më pak se një javë deri në hapjen e merkatos së transferimeve të janarit, të gjitha sytë janë te Marcus Rashford i Manchester Unitedit. Ai duket pothuajse i sigurt për t'u larguar nga klubi pasi është lënë jashtë skuadrave të fundit për ndeshje. Barcelona është lidhur fort me sulmuesin dhe, sipas "Football Transfers", ata tashmë i janë drejtuar Unitedit me qëllimin për të arritur një marrëveshje huazimi fillestar, e cila do të përfshinte një opsion për ta bërë transferimin të përhershëm për 42 milionë euro gjatë verës. Marcus Rashford edhe të dielën u la jashtë ekipit për ndeshje.

PSG-ja pëlqen Isakun, por çmimi është 100 milionë euro

Paris Saint-Germain nuk ka nevojë të ndërhyjë në merkaton e dimrit dhe po mendon qysh tani për afatin kalimtar të verës. Një nga objektivat kryesor do të jetë përforcimi i sulmit dhe, sipas asaj që raporton "Fichajes.net", pëlqehet Aleksandër Isak, që luan për Newcastle Unitedin. Sulmuesi suedez ka një kosto të madhe, teksa për t'i siguruar shërbimet e tij duhen 100 milionë euro. Isak ka realizuar 10 gola në këtë sezon.

Tyson Fury, i pavendosur për të ardhmen

Tyson Fury nuk ishte i gatshëm të përgjigjet saktë për të ardhmen e tij në boks pas humbjes së dytë radhazi ndaj Oleksandr Usyk. Pyetje sa i përket të ardhmes së dy herë kampionit të peshave të rënda u ngritën dhe ishin të

pashmangshme pasi u mposht nga Usyk për herë të dytë brenda shtatë muajsh. Fury, ndonëse në meçin e dytë ishte më i përgatitur, sërish u mposht me vendim unanimit të gjyqtarëve të cilët votuan me rezultat 116-112 në favor të

Usyikut. Britaniku tani ka dy humbje radhazi dhe në moshën 36-vjeçare është krijuar një pasiguri sa i përket të ardhmes së tij, një temë për të cilën as vetë ai nuk ofroi mjaftueshëm informacione. "Dua të shkoj në shtëpi dhe t'i festojë

Krishtlindjet. Unë kam punuar fort për këtë meç. Faleminderit të gjithëve që erdhën dhe më mbështetën! Ju mund të më shihni sërish duke luftuar, ose ndoshta jo", ka thënë Fury. Së fundmi u raportua se meçi i ardhshëm i Furyt mund të jetë

ai ndaj bashkëvendësit të tij Anthony Joshua. Këtë gjë e kishte zbuluar promotori Eddie Hearn i cili tha se do të punojë në këtë drejtim për ta organizuar atë që, sipas tij, do të ishte meçi më i madh në histori të boksit britanik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 2023/1
Dt: 23.12.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Mësimdhënës/e për Matematikë	Vend i lirë	1	5.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën një gjuhë zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokument personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, **duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI**
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim (kontratat e punës ose vërtetimi)
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit;
- Përjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portfolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit).

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të **MASHTI-it: UA Nr. 05/2021**, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Matematikë në shkollë të mesme të lartë:**
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.

- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitë dhe lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të dërgohen kandidatëve me e-mail dhe do të shpallen në <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe në webfaqe.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 24.12.2024 deri me 22.01.2025.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitë të shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Agron Krasniqi shpall te pavlefshme 2 Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300
dëftesat Q.K. "11 Marsi" Prizren. €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Elhan Selmic shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren. - Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Fahri Qereti shpall te pavlefshme dëftesën e kl X Q.K "11 Marsi " Prizren. - Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 2022/1
Dt: 23.12.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrat Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitive	Koeficienti i pagës
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Mësimdhënës/e Profili Teknik i dizajnit grafik	Vendi lirë	1	5.8
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Mësimdhënës/e Profili Mekatronik	Vendi lirë	1	5.8
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Mësimdhënës/e Profili INKU për lëndën Teknologji e instalimit të ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	Vendi lirë	1	5.8
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Mësimdhënës/e për lëndën e Vizatimit të lirë	Vendi lirë	1	5.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën një gjuhë zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklarim me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim (kontratat e punës ose vërtetim)
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit;
- Përfundimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit).

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për Profili Teknik i dizajnit grafik

- Mr.Sc. Akademia e Arteve - dega e grafikës ose dizajnit grafik;
- Inxh. i dip.- Akademia e Arteve - dega e grafikës ose dizajni grafik.
- Msc. Shkencave kompjuterike

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për Profilin- Mekatronik

- Msc i shkencave kompjuterike
- Ing i dipl. Elektroteknikës-automatikës/elektronikës

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e Profili INKU për lëndën Teknologji e instalimit të ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit

- Msc. i makinerisë
- Inxh. i dipl. i makinerisë

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndën e Vizatimit të lirë

- MSc. i arteve figurative;
- Prof. i arteve figurative

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silllet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitën e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të dërgohen kandidatëve me e-mail dhe do të shpallen në <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe në webfaqe.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 24.12.2024 deri me 22.01.2025.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitën e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 2020/1
Dt: 23.12.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullore (Ork) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrjtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
ShML	Qendra e Kompetencës në Ferizaj	Ferizaj	Instruktor/e të profilin Laborant Mjekësor	Vend i lirë	1	5.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njëri nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezumeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, **duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI**
- Çertifikatat e trajnimeve
- Dëshmi të përvojës së punës (kontratat e punës ose vërtetim)
- Për instruktor me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në ndërmarrje, biznese dhe institucione tjera
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portfolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit).

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Instruktor/e të përprofilin Laborant Mjekësor

- Përgatitje/kualifikim bachelor

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitën e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail dhe do të shpallen në <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe në webfaqe.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 24.12.2024 deri me 22.01.2025.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitën e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 2019/1
Dt: 23.1.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrat Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullore (Qrk) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita:	Vendi i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë	Prishtinë	Mësimdhënës/e për lëndët profesionale të Tekstilit	Zëvendësim	1	5.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njëri nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklarim me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezumeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim (kontratat e punës ose vërtetimi)
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit;
- Përgjithimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portfolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit)

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndët profesionale të Tekstilit

- Msc. i Tekstilit;
- Inxh. i dipl. i Tekstilit drejtimi i Konfeksionit;

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.

- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkohet apo të pranohet udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
